

THIRJE PËR APLIKIM PËR AKTIVITETE TË MARKETINGUT

Historiku

Me përkrahje të programit për Zhvillim Regjional Ekonomik të Bashkimit Evropian, financuar nga Bashkimi Evropian dhe menaxhuar nga Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë, LAG Rural + synon të kontribuojë në 11 komuna duke krijuar treg për gjithë prodhuesit e Regjionit Ekonomik Lindje, me forcim të punësimit të përgjithshëm me fokus në bujqësi dhe rritje të produktivitetit në tokat e punuara të Regjionit Lindje.

Me përfshirjen e të gjitha GLV-ve aktive të Regjionit Lindje të Kosovës: GLV (Ferizaj, Kamenicë, Kllokot, Ranillug, Novoberdo, Hani i Elezit, Kacanik, Shtërpçë, Viti) eksperiencën e anëtarëve do të kontribuojë në rritjen e zhvillimit ekonomik. Poashtu janë nënshkruar marrëveshje partneriteti nga GLV Rural+ dhe Komuna e Gjilanit, e cila do të marrë pjesë në bashkë-financim dhe do të jetë partner i projekt propozimit. GLV Rural + gjithashtu do të punojë edhe me organizatat tjera, organizatat vendore dhe ndërkombëtare në fusha të projekteve dhe agjensi tjera të zhvillimit të biznesit.

Duke pasur bashkëpunorë të jashtëm përveq bashkëpunimit mes 11 komunave, projekti mund të jetë më i efektshëm ndaj grupeve bujqësore të interesit dhe do të ketë gjithashtu një ndikim më të gjerë në zhvillim ekonomik të regjionit përmes shkëmbimit të ndërsjellë të ideve dhe përvojës, nëpërmjet bashkëpunimit të ndërsjellë.

Përshkrimi i Projektit

Qendra Regjionale e Marketingut është një zyrë ndër-komunale për stimulimin dhe vlerësimin e nevojave të Marketingut të produkteve vendore, e themeluar si pjesë e projektit të financuar nga Bashkimi Evropian "Qendra Regjionale për Marketing-Lindje" për grant projektin "Përkrahje nga BE për Zhvillimin Ekonomik Regjional" (EURED).

E themeluar në Mars të vitit 2013 nga GLV Rural + në partneritet me Komunën e Gjilanit, në cilësinë e implementuesit të projektit "Qendra Regjionale për Marketing-Lindje".

Bazuar në thirrjen për propozime të Zyrës së Bashkimit Evropian në Kosovë për grant projektin "Mbështetje nga BE për Zhvillimin Ekonomik Regjional" ky projekt propozim kontribuon në zhvillimin ekonomik regjional të Regjionit Lindje të Kosovës përmes përmirësimit të marketingut të produkteve vendore dhe të zhvillimit të përgjithshëm ekonomik të zonave rurale të Regjionit Lindje të Kosovës.

Objektiva e përgjithshme: Krijimi i kushteve të favorshme ekonomike për Regjionin Ekonomik Lindje.

Ky projekt propozim synon integrim të të gjitha rekomandimeve nga qeverisja Vendore, Qendrore dhe Regjionale, sic janë zhvillimi dhe përmirësimi i kualitetit të jetës përmes promovimit të produkteve vendore dhe aktivitete tjera ekonomike që përkrahin rritjen ekonomike, përmes sigurimit të të hyrave për fermerët dhe ndërrmarësit më qëllim të përmirësimit të standardeve të jetës dhe kushteve të punës në Regjionin Lindje të Kosovës.



Synimet e projektit janë:

Aktivitetet që do të ndërmiren janë të strukturuar në atë mënyrë që të ndërlidhen me objektivat e projektit, të cilat kontribuojnë në krijimin e kushteve të favorshme për zhvillimin e biznesit, si për agro-prodhuesit dhe ndërrmarësit e vegjël. Ky projekt propozim do të realizohet përmes këtyre objektivave specifike:

- Zhvillimi i produktit, dizajni dhe marketing i bizneseve të sektorit privat
- Shtimi i vlerës me promovimin e produkte të prodhuara dhe përpunuara vendore
- Krijimi i zingjirëve furnizues të prodhuesve

Qëllimi i grantit

Nën-grantet do të kontribuojnë në Marketing Regjional të produkteve vendore. Me stimulimin e zëvendësimit të produkteve jo vendore me ato vendore, me aplikimin e mjeteve dhe metodave për zhvillimin e produktit, dizajnimin dhe marketingun do të shtohet vlera e produkteve vendore nga produktet e ngajshme nga regjionet e tjera. Me qëllim të inkurajimit të palëve të interesuara të Regjionit Lindje të investojnë në Marketing, Qendra Regjionale e Marketingut ka bërë thirrje për propozim me qëllim të përkrahjes së produkteve vendore dhe rritjes së konkurrencës së produkteve në tregun vendor dhe regjional.

Objektivat kryesore të kësaj thirrje janë:

- Zhvillimi i dizajneve të produktit dhe materialeve promovuese
- Përkrahja në materialet paketuese që do të shtojnë vlerën e produkteve vendore.

Përkrahja e iniciativave të marketingut duhet të kenë ndikim në përmirësimin e kushteve të ruajtjes, kategorizimit dhe paketimit që do të ndikojnë direkt në marketingun e produkteve vendore.

Madhësia e granteve

Vlera e përgjithshme e vlefshme për nën-grante është 100.000 Euro për Regjionin Ekonomik Lindje të Kosovës.

Vlera maksimale e nën grantit për një prodhues vendor, Shoqatë, OJQ do të jetë 2000 Euro. Aplikacionet që tejkalojnë vlerën 2000 Euro nuk do të jenë të vlefshme.

Projekteve specifike mund t'u jepen grante me vlera më të larta veqanërisht grupeve të fermerëve dhe iniciativave ndër-komunale të shoqatave të prodhuesve vendor.

Me përkrahje të zhvillimit të produktit do të ketë ndikim të shpejtë në përmirësimin e kushteve të ruajtjes, kategorizimit dhe paketimit që do të ndikojnë direkt në marketingun e produkteve vendore.

Zonat e Intervenimit

Të gjitha veprimet e ndërrmara mëposhtë do t'u adresohen në mënyrë direkte marketingut të produkteve vendore dhe mund të financohen përmes kësaj thirje për aplikim:

- Klasifikimi adekuat sipas standardeve të klasifikimit me makineri adekuate
- Ruajtja e produkteve në kushte adekuate me qëllim të rritjes së vlerave të produkteve vendore
- Promovimi profesional i produkteve p.sh.(materiale të pakimit, broshurat, katalogjet, pop up banerët, roll up banerët)
- Promovimi i materialeve të korrjes me teknika adekuate që ruajnë kualitetin e produktit.

Shpenzimet e pranueshme

Shpenzime të pranueshme janë të gjitha shpenzimet të cilat bëhen për nevoja të zhvillimit të planit të marketingut të prodhuesve individual vendor ose shoqatave të prodhuesve lokal.

Shpenzimet e papranueshme

Më poshtë janë të paraqitura shpenzimet e papranueshme:

- Borxhet dhe dënimet për vonesat e borxheve;
- Dispozitat për humbjet ose detyrimet e mundshme në të ardhmen;
- Interesi i hazuar;
- Shpenzimet e deklaruara nga përfituesi dhe të mbuluara nga ndonjë veprim tjetër ose program i punës;
- Blerjet e tokës ose ndërtesave përveq kur është nevoja për implementim direkt të veprimit, kur pronësia mund t'i bartet përfituesve final dhe/ose partnerëve vendor, më së largu deri në fund të veprimit;
- Humbjet e këmbimit valuator;
- Kredi për palët e treta;
- Blerja e paisjeve të dorës së dytë;
- Gjobat, ndëshkimet financiare, shpenzimet dhe detyrimet e ngjajshme;
- Kontributet;
- Shpenzimet e amortizimit;
- Shpenzimet operative;
- Detyrimet bankare të, shpenzimet e garancionit dhe detyrimet e ngjajshme;
- Doganat ose detyrimet ndaj importit ose ndonjë detyrim tjetër.

Kohëzgjatja e Projektit:

Maksimum 4 javë nga koha e dorëzimit të propozimit.

Kush mund të aplikojë?

Organizatat Jo-qeveritare vendore, Shoqatat e Bizneseve dhe Prodhuesit vendor.
Individët dhe Organizatat apo Shoqatat e cekura më lartë nuk mund të dorëzojnë më shumë se një aplikacion.

Afati për dorëzimin e Aplikacioneve

Afati i fundit kohor për dorëzimin e aplikacioneve është **2 Prill 2014** ne ora 16:00 ne Zyren e Qendres Regjionale per Marketing - Lindje.

NJOFTIM: Aplikacionet e dorëzuara pas datës dhe kohës së caktuar më lart do të refuzohen në mënyrë të prerë.

Procesi i Aplikimit

a. Projekt propozimi i plotë dhe dizajnet e propozuara për dorëzim
Aplikuesit duhet të dorëzojnë dizajne dhe logo të kompanisë së tyre.
Aplikuesit mund të aplikojnë në gjuhën Angleze, Shqipe dhe Serbe, duke përdorur formatin që mund të shkarkohet nga ëeb-faqja:

www.marketingeast.com

Aplikuesit të cilët kalojnë duhet të marrin pjesë në zhvillim të materialeve në baza javore për 4 javë.

b. Dokumente shtesë

Cdo aplikues, së bashku me Projekt propozimin e plotë, duhet të dorëzojnë poashtu dokumentet e mëposhtme:

a. Kopjen e Certifikatës së Regjistrimit të Organizatës

b. Kopjen e ID Kartelës së personit kontaktues në atë Organizatë.

Në rast të iniciativave bashkëpunuese të fermerëve ata poashtu duhet të dorëzojnë marrëveshje bashkëpunimi dhe justifikimet me nënshkrim të bashkë përdorimit të materialeve promovuese, apo makinerisë për zgjedhje ose klasifikim.

c. Si të dorëzohet aplikacioni?

Aplikacioni duhet të dorëzohet në zarf të mbyllur në një (1) original dhe dy (2) kopje në madhësinë e fletës A4. Forma e kompletuar e aplikacionit gjithashtu duhet të dorëzohet në formë elektronike (CD)- por ruajta e aplikacionit duhet të bëhet atë formë që lejon modifikime me qëllime kontraktuese. Forma elektronike duhet të përmbajë po të njejtin aplikacion sikur se verzioni në letër i mbyllur poashtu në zarf. Në rast të mos dorëzimit të aplikacionit si në udhëzimet e kërkuara, aplikacioni do të shpallet jo i vlefshëm.

Adresa:

Qendra Regjionale e Marketingut

Rruga: Haqif Tetova – Ndërtesa e Inkubatorit të Binzesit, kati i tretë.

Aplikacionet e shkruara me dorë nuk do të pranohen.



Vlerësimi i Aplikacioneve

Të gjitha aplikacionet do të vlerësohen nga ekipi udhëheqës i projektit. Pas vlerësimit do të listohen aplikacionet më të mira dhe do t'i bëhet paraqitja e listës së ngushtë të aplikacioneve autoritetit kontraktues për aprovim.

Kriteret e përzgjedhjes

Pikët aplikuesve do t'u jepen duke u bazuar në kriteret e mëposhtme:

Sa është real dhe i zbatueshëm aktiviteti i propozuar	(40 pikë)
Përmbledhja e strategjisë (kreativiteti)	(20 pikë)
Kapaciteti për të menaxhuar aktivitetin	(20 pikë)
Ndikimi i shpejtë dhe qëndrueshmëria	(20 pikë)

Njoftim: Aplikuesit e përfshirë në programet trajnuese të projektit do të kenë 10 pikë shtesë.

Informata shtesë rreth aplikimit

Pyetjet rreth procedurave të aplikimit jo rreth përmbajtjes mund të dërgohen përmes e-mail adresës: info@marketingeast.org.

